



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2142/2 prot.,

Datë 30.07.2024

**FORMULAR PËR PUBLIKIM  
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR  
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR**

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “El-Gjo-2006” në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-09276-06-12-2024, me objekt: “*Furnizime me ushqime - Strehëza për fëmijët pa kujdes prindëror*”, me fond limit 1,254,795 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 28.06.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “El-Gjo-2006” SHPK, me NUIS J66902033R, me adresë: Lagjja Tre Heronjt, Rruga Pal Engjelli, zona kadastrale 8593, Shkoder.
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Shkodër  
Rr. 13 Dhjetori, Nr.1 Shkodër.

Në datën 30.07.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2024/4388, protokolluar me nr. 2142/2024 protokoli, e operatorit ekonomik “El-Gjo-2006” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-09276-06-12-2024, me objekt: “*Furnizime me ushqime - Strehëza për fëmijët pa kujdes prindëror*”, me fond limit 1,254,795 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 28.06.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “El-Gjo-2006” SHPK.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:  
b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”, Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “El-Gjo-2006” SHPK, kundërshton me anë të ankesës me nr. 2142 prot.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

**Arsyet e skualifikimit:**

*“Oferte pak me e larte dhe mungon certifikata e standartit ISO 22000 e cila duhej te paraqitej.”*

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 30.07.2024.

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**